



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE  
DREJTORIA MINERARE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .06.2021

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Z. Merxhan Daci,**

*Email. merxhan.daci@gmail.com, Cel. 0683527328*

Në përgjigje të suajës më datë 26.05.2021 ku kërkohet informacioni për mbikqyrjen e aktivitetit minerar të shfrytëzimit dhe tarifën mjedisore që subjektet paguajnë të cilat operojnë në Bashkinë Dimal ju informojmë si më poshtë vijon:

Në Bashkinë Dimal, Qarku Berat sipas rregjistrimit minerar rezultojnë 23 leje minerare shfrytëzimi që zotërohen nga 17 subjekte të cilat zhvillojnë aktivitet minerar për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e materialeve të ndërtimit si rërë, granit, çakëll etj.

Aktiviteti minerar në këtë Bashki ka filluar para viteve '90 dhe me miratimin e ligjit 7796 datë 17.02.1994 disa subjekte janë paisur me leje minerare shfrytëzimi të cilat vazhdojnë edhe sot.

Drejtoria Minerare pranë AKBN-së në zbatim të Ligjit 10304, datë 15.07.2010 neni 43, pika 3, mbikqyr dy herë në vit, harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare.

Bashkia Dimal, Qarku Berat është mbikqyrur në terren nga data 25-27.01.2021 dhe ka rezultuar që subjektet ushtrojnë aktivitet minerare brenda sipërfaqes së licencuar dhe kanë paguar garancitë e rehabilitimit.

Në kërkesën tuaj në lidhje me dëmet në mjedis detyrimet për rikuperimin e mjedisit ju sqarojmë si më poshtë :

Subjektet që janë paisur me leje minerare me ligjin 7796 datë 17.02.1994 deri në vitin 2010 kur është miratuar Ligji 10304, datë 15.07.2010 i amenduar, është aplikuar taksa e sipërfaqes ku për 1km<sup>2</sup> subjekti i licencuar paguante 1500 franga Zvicerane, kurse mbas miratimit të ligjit Ligjit 10304, datë 15.07.2010 u fut koncept i ri mbi garancinë e rehabilitimit, u bë vlerësimi i ri i vlerës për një hektar sipas llojeve të mineraleve metalorë dhe jo metalor i miratuar nga (ish METE) sot MIE.

Garancitë e Rehabilitimit që paguhen për çdo vit, kalojnë në thesarin e shtetit të cilat zhblllokohen në fund të jetës së karrierës, mbasi mbaron rehabilitimi dhe çertifkohet korrektësia e realizimit të tij.

Për subjektet minerare që operojnë në Bashkinë Dimal, Qarku Berat aplikohet vlera 322,750 lekë për një hektarë plus vendoset edhe taksa prej 240 365 lekë për impiantet e përpunimit që mbas mbarimit të aktivitetit të rehabilitojë sipërfaqen e prekur nga ky impiant.

Vlera e Garancisë së Rehabilitimit vendoset në Këshillin Teknik të AKBN-së, ku mbrohet projekti teknik në momentin kur subjekti pajiset me leje minerare shfrytëzimi për sipërfaqen

që ai ka paraqitur për tu prekur nga aktiviteti mineral referuar prodhimin që ai ka paraqitur në momentin që ka konkuruar në MIE dhe është shpallur fitues.

Referuar këtyre të dhënave grupi i specialistëve që shkon në mbikqyrje përveç kontrollit për zbatimin e projektit kontrollon edhe sipërfaqen e prekur krahasuar me pagesat e kryera sipas vlerave të përcaktuara në lejen minerare të lëshuar nga Ministri dhe QKB e cila edhe mund të rritet në rast se subjekti ka prekur më shumë sipërfaqe në krahasim me planifikimin e bërë dhe miratuar dhe kjo rritje bëhet në zbatim të VKM Nr. 741 datë 09.09.2015.

Në Bashkinë Dimal subjektet kanë paguar Garancitë e Rehabilitimit në zbatim të vlerave të përcaktuara në formatin e lejes minerare të lëshuar nga Ministri dhe sipërfaqes së matur në terren nga specialistët Ing. Markshajder në momentin e kontrollit, pra sipërfaqja e prekur përputhet me garancitë e paguara nga subjektet.

Më poshtë është vendosur tabela me lejet minerare me të dhënat në Bashkinë Dimal, Qarku Berat.

Për sa i përket rehabilitimit të sipërfaqes së prekur, garancitë e investimit për mjedisin që grumbullohen, vihen në dispozicion për rehabilitimin e mjedisit dhe për këtë bëhet një raport përfundimtar i mbylljes dhe rehabilitimi i sipërfaqes nga subjekti i cili monitorohet dy vite rresht nga struktura përgjegjëse e AKBN-së.

***Tabela Nr. 1: Lista e Lejeve Minerare të Shfrytëzimit***

Nr	Nr. Leje	Date	Emri i subjektit	Bashkia	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit	Sip. licensuar (ha)	Garancia e Rehabilitimit e paguar
1	623/1	13.06.2001	VellezritLlupo shpk	Dimal	Konizbalte	Gurgëlqer or	1.4	550,674
2	685/1	23.12.2002	SalillariSh.p.k	Dimal	Konizbalte-Dinaku,	Gurgëlqer or	17.96	2,344,613
3	697/1	30.04.2003	GURI I BARDHE shpk	Dimal	Guri i Bardhe, Veterik,	Gurgëlqer or	8.94	2,730,600
4	704/1	02.06.2003	GANT CONSTRUCT ION	Dimal	Kodra e Gjelber	Gurgëlqer or	1.24	378,938
5	728/1	22.09.2003	SHPIRAGU shpk	Dimal	UraVajgurore	Gurgëlqer or	3.04	966,880
6	739/1	05.12.2003	2 P 06 shpk	Dimal	Poshnjë, Berat	Gurgëlqer or	5.88	1,328,005
7	742/1	05.12.2003	AGBES KONSTRUKSION shpk	Dimal	Kodra e gjelbertPas halliKonizbalt,	Gurgëlqer or	12.17	4,300,456

8	778/1	26.07.2004	RENALDO shpk	Dimal	Konizbalte,	Gurgëlqer or	3.8	1,032,426
9	779/1	26.07.2004	ZHOPI shpk	Dimal	Veterrik, jug te Ures Vajgurore	Gurgëlqer or	5.4	1,554,089
10	793/1	18.08.2004	AKS shpk	Dimal	Guri I Bardhe, Uravajgurore	Gurgëlqer or	2.15	640,052
11	875/2	23.06.2005	Vellezrit Llupo shpk	Dimal	Konizbalte	Gurgëlqer or	3.8	950,530
12	898/1	08.08.2005	KOLOSEU - Koshpk	Dimal	Guri I Bardhe, Uravajgurore	Gurgëlqer or	10.15	1,514,092
13	911/2	02.09.2005	Salillari Sh.p.k	Dimal	Guri I Bardhe, Uravajgurore	Gurgëlqer or	9.11	2,146,740
14	969/1	05.09.2006	BETA shpk	Dimal	Kodra Gorices	Gurgëlqer or	8.61	1,427,305
15	1378/1	24.06.2009	Mustafaishpk	Dimal	Kodra e Gurite Bardhe	Gurgëlqer or	18.05	3,357,009
16	1577	07.09.2012	Ardmirshpk	Dimal	Objekti "Kodra e Konizbaltes"	Gurgëlqer or	9.89	1,161,900
17	1632	10.06.2013	Salillari Sh.p.k	Dimal	Ura Vajgurore	Gurgëlqer or	16.26	1,566,240
18	1658	26.08.2013	AKS shpk	Dimal	Ura Vajgurore	Gurgëlqer or	7.72	892,824
19	1659	27.08.2013	Vellezrit Llupo shpk	Dimal	Kodra e Konizbaltës, Ura Vajgurore	Gurgëlqer or	19.5	813,296
20	1703	23.05.2014	Hazbiu F shpk	Dimal	Mbreshtan	Gurdekora tiv	37.7	125,593
21	1806	21.06.2016	Klisa shpk	Dimal	Objekti Vokopolë	Gurgëlqer or	55.42	1,000,000
22	1816	29.08.2016	Beta shpk	Dimal	Objekti Pashallia, Berat	Gurgëlqer or	16.99	643,520
23	1891	18.05.2020	Sinametashpk	Dimal	Obj. Ura Vajgurore, qarku Berat	GurGëlqer or	36.5	172,281

Faleminderit për bashkëpunimin.